



## UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës  
[www.uni-gjilan.net](http://www.uni-gjilan.net) tel: 0280390112

---

### PLANI I VEPRIMIT I FAKULTETIT TË SHKENCAVE SOCIALE(FSHS)

#### PER VITIN AKADEMIK 2024/25

##### **Misioni:**

Misioni i programit është: të përgatisë kuadro për të përmbushur kërkesat e ngritura nga kompleksiteti i jetës ndërkombëtare, ndërvarësia politike, globalizimi i ekonomisë dhe tregut, universalizimi i komunikimeve, nëpërmjet përhapjes së kulturave dhe socializimit të botës, duke u siguruar studentëve kushte shkencore, teknike që u mundësojnë zhvillimin e dijeve, mendimit kritik, për të kryer funksione në organizata ndërkombëtare, në korporata vendore dhe transnacionale, në institucione shtetërore dhe rajonale, organet e pushtetit vendor dhe institucionet tjera.

##### **Vizioni:**

Programi i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Studimeve Evropiane në Universitetin Publik "Kadri Zeka" (UKZ) synon të përgatisë studentë të pajisur me njohuri të thella dhe aftësi profesionale për të kuptuar dhe analizuar në mënyrë kritike kompleksitetin e politikës ndërkombëtare, dinamikën e integritimeve evropiane dhe rolin e organizatave ndërkombëtare. Vizioni i FSHS-së është krijuar në përputhje me parimet dhe misionin e universitetit për të adresuar nevojat e tregut të punës dhe për të kontribuar në zhvillimin e kuadrove që mund të ndihmojnë në proceset diplomatike dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

##### **Vlerat:**

Vlera e Fakultetit qëndron në aftësinë e tij për të prodhuar kuadro të përgatitura për të adresuar sfidat komplekse të botës moderne, përmes një qasjeje ndërdisiplinore dhe bashkëpunimi të ngushtë me ekspertë të fushës, që përforcon misionin e tij për të kontribuar në një Kosovë më të integruar dhe më aktive në skenën ndërkombëtare.

FSHS dhe Programi i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Studimeve Evropiane në Universitetin Publik “Kadri Zeka” ka për qëllim përgatitjen e kuadrove të kualifikuara në diplomaci, marrëdhënie ndërkombëtare dhe integritime evropiane, duke ofruar një kombinim të njohurive teorike dhe praktikave me qasje të avancuar akademike. Duke përmbushur nevojat e tregut të punës, ky fakultet i pajis studentët me aftësi kritike dhe analitike përmes moduleve të specializuara dhe bashkëpunimit me ekspertë ndërkombëtarë. Në këtë mënyrë, fakulteti kontribuon në avancimin profesional të studentëve dhe zhvillimin e shoqërisë, duke i përgatitur ata për karrierë në institucione vendore dhe ndërkombëtare, dhe njëherazi për të ndjekur studime të mëtejshme, për të përfaqësuar denjësisht Kosovën në arenën ndërkombëtare dhe për të ndihmuar në proceset e integritimeve euroatlantike.

### **Objektivat strategjike të fakultetit:**

Objektivat e programit:

- **O1** - Studentët të zhvillojnë një kuptim të qartë për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe studimet evropiane.
  
- **O2** Të rriten aftësitë e studentëve për të analizuar, vlerësuar, interpretuar dhe kuptuar aspektet teorike të çështjeve të shqyrtuara me reflektim sistematik kritik në aktivitetet që zhvillohen gjatë studimeve.
  
- **O3** Fokus i lartë në aktualitete, çështjeve moderne, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe organizatave, teorive të konfliktit dhe bashkëpunimit, teorive të integritimit evropian dhe ekonomisë politike ndërkombëtare.
  
- **O4** Të zhvillohen aftësitë e buta dhe praktike të studentëve, dhe të përdoren metodat e kërkimit që përgatisin studentët për punë analitike, qasje dhe botëkuptime me cilësi të lartë profesionale dhe në shkencore.
  
- **O5** Të përgatisin studentë që do të zhvillojnë karrierë suksesshëm në tregun vendor, rajonal dhe global të punës ose të vazhdojnë studime pasuniversitare në universitetet jashtë Kosovës.

### **Organizimi dhe zhvillimi i fakultetit:**

(Dekani - Selimi)

## Mësimdhënia:

Mësimdhënia dhe mësim-nxënia në programet studimore të UKZ bazohet, fillimisht në rregulloret e aprovuara nga ana e Senatit. Ky proces është i orientuar kah studentit: studentit është qendra dhe i gjithë procesi funksionon në interes të ngritjes së tij intelektuale, hulumtuese dhe sociale.

Disa prej përparësive të UKZ janë:

- syllabuset e lëndëve rishikohen dhe miratohen në KF në fillim të semestrit;
- ligjëratat dhe ushtrimet organizohen me qasje dhe metoda fleksibile për studentin;
- përveç librave obligativë dhe atyre të sugjeruar, studentëve u vihen në dispozicion edhe materiale të nevojshme konkretizimi;
- organizohen vlerësime periodike dhe të vazhdueshme-gjatë tërë semestrit;
- përdorimi i IT-së dhe aplikacionit e-learning ([SMU](#), [Moodle](#), [TEdu](#), [Google](#));
- konsultimet e rregullta me mësimdhënësit etj.
- në të gjitha programet studimore kujdes i kushtohet punës praktike; në disa programe në Fakultetin e Edukimit, në Fakultetin e Shkencave Aplikative, në Fakultetin Juridik, praktika është pjesë obligative e programit studimor.
- Mësim-nxënia plotësohet edhe me aktivitete të lira akademike, të cilat zhvillohen përmes klubeve të ndryshme, si Klubi i Oratorëve, Klubi i IT, Klubi i Matematikanëve, të cilat mbajnë gara në fushat e tyre.

Vlerësimi i studentëve shprehet me notë të barasvlershme me Sistemin e Bolonjës.

Për vlerësim të programit, procesit të mësimit dhe metodologjisë, realizohen monitorime të rëndomëta nëpër sallat e mësimit, poashtu çdo lëndë, çdo profesor, asistent vlerësohet nga studentët dhe menaxhmenti në periudhën e parapërfudnimit të semestrit.

Mësimdhënësi është i detyruar që pas përfundimit të rezultateve përfundimtare të provimit, më së largu brenda 72 orësh t'ia dorëzojë zyrtarit të shërbimit të studentëve raportin e provimeve, bashkë me listën e studentëve si dhe kopjet fizike të fletëparaqitjeve të shkarkuara nga sistemi SMU. Format e mbajtjes së provimit janë: provimi me shkrim, provimi me gojë, provimi me shkrim dhe me gojë, provimi me test, provimi praktik dhe kolokuiumi. Mësimdhënësit janë të obliguar që pas vlerësimit të mbajnë konsultime me student, të spjegojnë dhe të inkurajojnë ata për rezultate më të larta.

Vlerësimi i provimit shprehet me notë:

Nota në UKZ	Përshkrimi me fjalë	Barasvlefshme me Sistemin e Bolonjës
10	shkëlqyeshëm	A
9	Shkëlqyeshëm	B
8	Shkumë mirë	C
7	Mirë	D
6	Mjaftueshëm	E
5	pamjaftueshëm	F

Studentët duhet të arrijnë notën minimale 6 për kalueshmëri, që do të thotë se studentët duhet të arrijnë minimum 50% të notës përfundimtare për lëndët përkatëse.

Roli vendimmarrës i studentëve në strukturat organizative të UKZ-së zhvillohet nga pjesëmarrja e tyre në organet vendimmarrëse: Bazuar në Statutin e UKZ-së, dy përfaqësues të studentëve janë anëtarë me të drejtë vote në Senatën e UKZ; në Këshillin Drejtues është një anëtar – student-vëzhgues; në Komisionin për studime dy studentë me të drejtë vote; në Këshillin e Fakultetit studentët janë të përfaqësuar me nga një anëtar për secilën njësi akademike, me të drejtë vote. Për organizimin e aktiviteteve të studentëve, menaxhmenti i UKZ-së ka siguruar përkrahje të plotë, duke siguruar hapësirë të nevojshme dhe logjistikë tjetër të nevojshme.

Organizimi i procesit mësimor në UKZ është gjithnjë në funksion të politikave të Qeverisë për arsimin e lartë në Kosovë. Të gjitha vendimet e sjella nga MASHT implementohen në UKZ. Në UKZ zbatohet organizimi i kurrikulave (planprogrameve studimore) bazuar në sistemin e tri cikleve të arsimit të lartë, Sistemin Evropian të Transferit të Kredive (ECTS) dhe zbaton të gjitha rekomandimet e procesit të Bolonjës. Përcaktues i rendësishëm i punës në Universitetin “Kadri Zeka” është Plani Strategjik i UKZ-së 2023-2028.

UKZ po kontribuon në ndërtimin e një shoqërie të re në Kosovë duke krijuar vlera për të gjithë pjesëmarrësit e saj, duke filluar nga të rinjtë deri te familjet, institucionet dhe bizneset. Përpjekjet tona për reformim ndjekin një model të avancuar, i përshtatur për kohën tonë dhe inspiruar nga përparimet në fushën e arsimit universitar.

Ndërsa shikon drejt të ardhmes, UKZ e ka prioritet që të ndërtojë një mjedis arsimor të fokusuar në student dhe në zhvillimin e mendimit kritik. Në kundërshtim me shkollat tradicionale, ne nuk përqëndrohemi vetëm në mësimin e fakteve, por inkurajojmë një qasje të gjerë ndaj dijes, duke përfshirë mendimin kritik, shikimin multidisiplinor, njohuritë e botës virtuale dhe adaptimin ndaj tregut global të punës.

Ne shpresojmë të formojmë një model të ri të studentit, të cilin e kultivojmë për të qenë i përgatitur për sfidat e kohës së sotme dhe të ardhshme. Besojmë se kjo qasje do të kontribuojë në formimin e një brezi studentësh të aftë për të shpërbërë sfidat komplekse në shoqërinë moderne dhe për të sjellë ndryshime pozitive në të gjitha sferat e jetës.

## **Hulumtimi:**

[Plani strategjik i UKZ 2023-2028](#), i rishikuar në vitin 2023, përmban një kapitull të veçantë për Objektivat Strategjike. Në kuadër të këtyre objektiveve është dhe Objektivi strategjik 2 i cili paraqet Zhvillimin e aktivitetit shkencor për përmirësim të cilësisë së studimeve dhe inovacion. Aty parashihet rritja e hulumtimit shkencor nëpërmjet mbështetjes financiare.

Në plan Strategjik është paraparë që të bëhet themelimi i Instituteve Hulumtuese, të bëhet planifikimi dhe zhvillimi i projekteve prioritare hulumtuese, të punohet inensivisht në drejtim të zhvillimit të mekanizmave për avancim të punës shkencore të personelit. Gjithashtu, të rritet pjesëmarrja në fondet e shkencës në vend dhe BE, si dhe të zhvillohen mekanizma për promovimin e punës shkencore të Universitetit. Si indikator për jetësimin e objektivit për zhvillim të aktivitetit shkencor është paraparë që të themelohen dhe funksionalizohen së paku dy institute kërkimore në universitet në bazë të rregullores së brendshme, ku secili institut implementon së paku një projekt hulumtimi dhe zhvillimor.

Objektivat kërkimore të programit, bazuar në dokumentet strategjike të Universitetit janë:

- Zhvillimi i vazhdueshëm i stafit për metodologjinë e kërkimit shkencor;
- Trajnime për studentët për metodologjinë e kërkimit shkencor;
- Përfshirje të stafit dhe studentëve në projekte hulumtuese rajonale dhe ndërkombëtare;
- Publikimi i hulumtimeve shkencore, një në vit për staf;
- Inkurajimi i punës kërkimore të përbashkët profesor-student;
- Krijimi i bordit këshillëdhënës të programit;
- Themelimi i laboratorit të hulumtimeve për shkencë sociale;
- Aplikimi në programe ndërkombëtare të shkëmbimit;
- Aplikimi për fonde shkencore në programet vendore dhe ndërkombëtare;
- Organizimi dhe pjesëmarrja në konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare;
- Organizimi dhe pjesëmarrja në aktivitete profesionale (debate, simpoziume, konferenca, tryeza);

Programi zhvillojnë një plan të punës kërkimore në bazë të një plani orientues në nivel universiteti. Programi organizon ekipet e hulumtimit sipas fushave duke synuar edhe ekipet ndërdisiplinare dhe në ndërlidhje me punën e instituteve. Programi do të aplikoj me së paku një projekt në vit në fondet vendore. Programi ka për objektiv që punën kërkimore-shkencore të e lidhë me nevojat e komunitetit. Rezultatet e hulumtimeve të jenë në shërbim të shoqërisë.

Duke marrë parasysh se programi Horizon Europe është një ndër instrumentet e rëndësishme për mbështetjen e kërkimeve atëherë janë organizuar [trajnime](#) për shkrim të projekteve si dhe për përgatitjen e aplikacionit si dhe implementimin e projektit ne Horizon Europe.

UKZ mbështet botimin e veprave shkencore dhe të teksteve universitare, publikimin në revistat shkencore dhe nxit punën kërkimore-shkencore të stafit akademik, duke ofruar mbështetje, si në aspektin teknik ashtu edhe në atë financiar. Është miratuar edhe [Rregullorja për Veprimtari Kërkimore Shkencore të UKZ](#), me anë të cilës, do të përkrahet stafi akademik në hulumtime dhe publikime shkencore.

UKZ ka mbështetur mbi 50 punime shkencore të mësimdhënësve duke u mbështetur në rregulloren për publikime shkencore dhe gjithashtu këto punime janë përkrahur financiarisht, shiko vendimet ([Vendimin Nr.02/3148](#), [Vendimin Nr.02/1910](#), [Vendimin Nr.02/2136](#)) Si dhe në vijim thirrjet për mbështetje financiare të publikuara në Ueb [Thirrja 2023](#), [Thirrja 2022](#) . UKZ ka përkrah financiarisht profesorët që kanë publikuar një deri dy punime në revista shkencore të indeksuara në SCOPUS ose WoS-SCIE.

Në këtë aspekt, UKZ ka paraparë edhe organizimin e konferencave shkencore vendore dhe ndërkombëtare. Universiteti themelon fondin e shkencës në baza vjetore për stimulim të punës shkencore. Financohen së paku dy publikime shkencore të një stafi akademik për publikimet në databazat SCOPUS dhe Web of Science. Gjithashtu, financohet pjesëmarrja e së paku një konference shkencore ndërkombëtare në vit për secilin staf akademik sipas kriterëve të përcaktuara nga rregullat në fuqi në UKZ. Si financim tjetër nga ana e Universitetit është edhe financimi i së paku një projekti për njësi akademike në vit nga fondi vjetor. Sigurohet qasja për stafin dhe studentët edhe në databazat e EBSCO dhe ScieneDirect në mënyrë që të ju krijohet lehtësi në qasje të dokumenteve të nevojshme për hulumtime shkencore. Që të prodhohen punime shkencore sa më cilësore dhe të kenë një impact faktorë të nevojshëm dhe të duhur ju sigurohet qasje si stafit gjithashtu dhe studentëve ne softuerë antiplagjiaturë.

Këshilli Drejtues ka ndarë 30.000 Euro për financimin e publikimeve shkencore të stafit akademik. Kjo shumë asnjë vit nuk është shfrytëzuar mjaftueshëm, dhe mundësia për stafin e programit për të shfrytëzuar këtë buxhet është shumë e lartë. Programi synon që së bashku me njësitë akademike të organizojë së paku një konferencë shkencore në vit, dhe si njësi të participojë në organizimin e konferencave të tjera vendore, rajonale apo ndërkombëtare, si pjesë organizative dhe si pjesëmarrës. Organizimi i tryezave dhe konferencave shkencore do të jetë prioritet i UKZ-së në mënyrë që temat me interes të debatohen dhe analizohen në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë akterët e tjerë që kanë ndikim direkt dhe indirekt në tematikat e ngritura. Do të tentohet që të shfrytëzohet buxheti i organizatave të tjera për përkrahjen e hulumtimeve dhe publikimit të artikujve shkencor. Mundësitë janë nga MASHT, HERAS PLUS, USAID, Komisioni Evropian, Western Balkan funds, Visegrad funds dhe të tjera.

Senati i UKZ-së ka miratuar Strategjinë për Hulumtime Shkencore. Strategjia përkufizon se çfarë nënkuptohet me veprimtari kërkimore shkencore në UKZ. Strategjia ka listuar objektivat në hulumtimin shkencor. UKZ përkrah projektet hulumtuese për të cilat ka kërkesa nga NJA (njësia akademike).

Me rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik, është përcaktuar qartë se stafit akademik do ti vlerësohet performanca kërkimore-shkencore për promovim të mëtejshëm akademik.

Veprimtaria shkencore-hulumtuese dhe artistike vlerësohet sipas:

- numrit të publikimeve në tri vitet e fundit;
- numrit të citimeve nga autorët e huaj (të dhëna nga bazat e citimeve);
- numrit të përgjithshëm të projekteve të paraqitura në tri vitet e fundit (kombëtare dhe ndërkombëtare);
- numrit të përgjithshëm të projekteve të realizuara në tri vitet e fundit (kombëtare dhe ndërkombëtare);
- pjesëmarrjes në seminare, konferenca, këshilla shkencor (vendore dhe ndërkombëtare) në tri vitet e fundit);
- numrit të përgjithshëm të mbledhjeve të organizuara shkencore në tri vitet e fundit nga ana e UKZ.

Me anë të Rregullores për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore e UKZ-së, bëhet e mundur rritja e pjesëmarrjes së stafit në punë kërkimore shkencore, duke i stimuluar edhe në aspektin financiar, por gjithashtu duke e bërë të detyrueshme edhe pjesëmarrjen dhe një minimum të publikimeve në baza vjetore. Ky do të jetë edhe synimi i programit marrëdhëniet ndërkombëtare dhe studimet evropiane. Programi nuk përkrahë rritjen eksponenciale të publikimeve shkencore. Programi konsideron cilësinë e publikimeve dhe bazohet në punë të mirëfilltë, e rezultate të pranueshme shkencore dhe akademike.

Në Rregulloren për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore përcaktohen vlerat e pagesave financiare për çdo publikim në revistat e rëndësishme ndërkombëtare me impakt faktor. Po ashtu rregullorja e nxitë punën kërkimore e shkencore edhe me shpalljen e “hulumtues i vitit” të personit i cili ka realizuar arritjet më të mira hulumtuese e shkencore brenda vitit.

Për të rritur nivelin bashkëpunimit me institucionet dhe subjektet biznesore ka themeluar dhe [Bordin Këshillëdhënës Industrial në Universitetin Publik “Kadri Zeka” dhe ka zgjedhur kryetarin e ri](#). Bordi industrial do të ndihmojë universitetin që të ndërtojë një imazh më të mirë, të bëjë ndërlidhjen e perspektivës industriale në programet universitare, do të bëjnë akumulimin e garantëve kërkimore, projekte të dizajnuara nga studentët, organizimin e praktikës së studentëve. Një nga objektivat më të rëndësishme të Bordit Këshillëdhënës Industrial (BKI) është të kontribuojë në suksesin strategjik të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan dhe të programeve studimore të fakulteteve të tij.

Programi do të themeloj bordin këshillëdhënës të programit dhe do të përfshijë të gjitha palët e interesit. Edhe në planin kulturor, parashihet që programi të ketë impakt të rëndësishëm të punës kërkimore-shkencore në komunitet. Anëtarë të stafit akademik do të organizojnë, simpoziume, konferenca, tryeza diskutimi, simpoziume kulturore, promovime kulturore, në bashkëpunim me komunitetin dhe në dobi të studentëve. Programi synon që përmes trajnimeve të zhvilloj kapacitet e stafit dhe të studentëve për kërkime shkencore.

#### Studentët:

Numri i studentëve të rinjë për pranim në programin studimor të UKZ përcaktohet nga AKA me rastin e vendimit për akreditim të programit. Në kuadër të këtij numri, MASHTI i Kosovës përcakton edhe kuotat e rezervuara për studentët nga komunitetet minoritare të Kosovës. Në vitin e parë të studimeve mund të regjistrohen të gjithë kandidatët të cilët kanë kryer shkollat e mesme të Larta (shkollimi 12 vjeçar), kanë dhënë provimin e maturës dhe kalojnë testin pranues të organizuar nga njësia akademike e UKZ-së. Për të gjithë kandidatët e interesuar, njësia akademike, formon Komisionet për pranimin e studentëve dhe Komisionet për shqyrtimin e ankesave të cilat veprojnë në bazë të Rregullores për pranimin e studentëve.

Këshilli i studentëve ka përfaqësuesit e tij në të gjitha komisionet e pranimin dhe të ankesave. Njësia akademike për pranimin e studentëve organizon provimin pranues, përgatit testet e provimit dhe aspektet tjera të nevojshme për një selektim korrekt dhe të drejtë, duke evidentuar tërë ecurinë në Procesverbalin e provimit pranues. Pas publikimit të rezultateve preliminare të listës së kandidatëve të pranuar, kandidatët që nuk janë pranuar kanë të drejtë ankese. Të gjitha ankesat e paraqitura shqyrtohen nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave, i cili i përgjigjet Dekanit të njësisë akademike për secilin rast me një vendim të arsyeshëm. Pas vendimit të komisionit për shqyrtimin e ankesave, Komisioni për pranimin e studentëve të rinjë shpall rezultatet finale. UKZ ka krijuar edhe Komisionin Qendror, i cili shqyrton të gjitha ankesat në shkallë të dytë. Kandidatët nga vendet jashtë Kosovës, para konkurrimit bëjnë nostrifikimin e shkollimit të tyre.

Programi ofron orientim për fillimin e vitit akademik për studentet për të siguruar një kuptim të plotë shërbimeve dhe lehtësive në dispozicion të tyre, politikat dhe procedurat në institucion dhe të drejtat dhe përgjegjësit e tyre.

Çdo fillim vit të ri akademik organizohet pranimi solemn për studentet e rinjë. Pritja e studentëve të rinj organizohet në secilin njësi akademike.

Dekani prezanton stafin akademik, programin studimor, përgjegjësitë dhe të drejtat e studentëve, lehtësitë dhe rregullat e tjera të njësisë akademike. Të gjithë studentët e pranuar pajisen me ID- kartela dhe e-maila zyrtar për shërbimet elektronike në sistemin SMU.

Në këtë mënyrë studentëve u mundësohen lehtësira në procesin mësimor: ligjërata, ushtrime, përgatitja e provimeve, evidentimi i vijueshmërisë, përdorimi i bibliotekës, laboratorëve, e të ngjashme.

Vend të posaçëm në strukturat organizative i është kushtuar pjesëmarrjes së studentëve. Në bazë të statutit të Universitetit, dy përfaqësues student janë anëtarë me të drejtë vote në organin më të lartë të Universitetit – Senatin; në Këshillin Drejtues është një anëtar-student vëzhgues; në Komisionin për studime, dy studentë marrin pjesë me të drejtë vote dhe në Këshillin e Fakultetit me të drejtë vote marrin pjesë 2 përfaqësues i studentëve.

Për organizimin e aktiviteteve të studentëve, menaxhmenti i UKZ-së ka siguruar përkrahje të plotë, duke siguruar hapësirë të nevojshme dhe logjistikë tjetër të nevojshme.

UKZ ka disa forma të përkrahjes financiare të studentëve:

1. [Institucioni ka një fond vjetor \(65.000 Eur\) për bursat universitare të studentëve.](#) Senati i përcakton kriteret e konkursit për bursa studentore ndërsa KD përcakton: fondin e bursës.
2. Për studentët e UKZ sigurohen edhe bursa nga MASH e Kosovës.
3. Studentët e UKZ përfitojnë bursa edhe nga komunat nga të cilat vijnë.
4. Bursat nga operatorët ekonomikë dhe bizneset.
5. Bursa jepen edhe nga Rotary Club e Komunës së Gjilanit

Administrata e UKZ në Gjilan është në shërbim të studentëve dhe të përpunojë dhe arkivojë me kujdes secilin dokument i cili gjenerohet nga Institucioni apo është pjesë e dokumentacionit të dosjes së studentit në kopje elektronike dhe kopje fizike. Kështu, (shih SMU-në në ëeb faqe të UKZ-së. Administrata përveç që është përgjegjëse për dokumentacionin e stafit, mësimdhënësve dhe të punonjësve tjerë të Institucionit; kujdeset edhe për: Dokumentacionin e kandidatëve që paraqiten për regjistrim në UKZ, Dokumentacionin e studentëve të UKZ; Mbarëvajtjen e provimeve dhe dokumentacionit të nevojshëm për provime të studentëve; Mbarëvajtjen dhe informimin me orarin e ligjëratave; Bibliotekën e Universitetit dhe pasurimin e saj; Mirëmbajtjen e shërbimeve të internetit; Punët e tjera që kanë të bëjnë me jetën studentore. Pjesë e posaçme e punës së stafit akademik është orari i konsultimeve me studentë. Çdo mësimdhënës është i obliguar të shpall orarin e konsultimeve me studentë, së paku një herë në javë. Bazuar në misionin e UKZ-së, preokupim kryesor i UKZ-së është përgatitja e studentëve për karrierë të suksesshme. Pjesë e procesit mësimor në të gjitha fakultetet është mësimi praktik, për këtë arsye, UKZ ka lidhë marrëveshje me institucionet përkatëse për zhvillimin e mësimit praktik.

Që nga vitin akademik 2019/20 në bashkëpunim të Zyrës së Shërbimit për Student dhe Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi nëpërmjet platëformës SMU bëhet [vlerësimi i shërbimeve të administratës](#), ku studentët përmes plotësimit të pyetësorëve të hartuar për të matur kënaqësinë e studentëve me shërbimet e administratës japin vlerësimin e tyre.

Fokusimet më të rëndësishme për ne si program janë parimet e paraqitura në tri e mëposhtme:

- Fokusimi evropian dhe ndërkombëtar në të gjitha fushat e arsimit të lartë që i sigurojnë studentit dhe personelit lëvizshmëri dhe krahasueshmëri të standardeve në dhënie të diplomave dhe kualifikimeve;



- Përkushtim në punë kërkimore dhe akademike për ta mbështetur mësimdhënien dhe mësimnxënien si dhe për t'i zgjeruar kufijtë e njohurive brenda Kosovës dhe jashtë saj; dhe
- Angazhim aktiv të studentëve si në aspektin individual, ashtu edhe në atë kolektiv, në jetën e institucionit dhe në mësimnxënien e tyre.

Kështu, studentët e programit krahas këtyre parimeve të vendosura nga UKZ, mund të jenë pjesë e shkëmbimeve studentore me Universitetet jashtë vendit, duke krijuar kështu të gjitha parakushtet që studentët tanë të kenë karrierë të suksesshme pas përfundimit të studimeve në UKZ. Gjithashtu, studentët e programit gjatë diplomimit dhe pas diplomimit do të përfitojnë mundësi të studimeve bachelor dhe master në universitetet e tjera evropiane me anë të projekteve ERASMUS dhe të tjera.

UKZ ka lidhur partneritet edhe me USAID, OSBE, Ambasadën e SHBA-së në Kosovë, programin Fulbright, Programin Erasmus+, HERAS, etj. të cilat sjellin mundësi shkëmbimi të studimeve dhe përvojave me vende të ndryshme të botës.

Në UKZ, biblioteka është e vendosur në katin e tretë, dhe shërben jo vetëm për huazimin e librave, por edhe si një sallë studimi. UKZ ka listën e mëposhtme të librave, punimeve shkencore, etj., në formë fizike në Bibliotekën e Universitetit, si dhe në bibliotekën digjitale të UKZ e-biblioteka. Studentët e UKZ gjithashtu kanë qasje në Bibliotekën e Universitetit Frankophone. UKZ ka një marrëveshje me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës që u siguron studentëve tanë qasje në rreth 800,000 tituj librash dhe gjithashtu ka lidhur Marrëveshje me Asociacionin e Bibliotekave Elektronike të Kosovës për të ofruar mundësi për të pasur qasje në bibliotekat digjitale në internet.

Shfrytëzimi i konviktit të studentëve dhe mensës bëhet në Konviktin e nxënësve dhe të Studentëve. Aktivitetet sportive si volejboli dhe aktivitetet përkatëse rekreative për studentët, zhvillohen në sallën e sportit në kampusin e shkollave të mesme të Gjilanit. (shih Aneksi-Marrëveshja me Drejtorinë e Arsimit të KK Gjilan. Marrëveshja për ambulantë në UKZ, e cila ju siguron qasje në kujdesin e parë shëndetësor të gjithë studentëve si dhe personelit tjetër të UKZ.

Universiteti është i përkushtuar në ofrimin e një ambienti të përshtatshëm për studentët në shumë aspekte. Disa nga aspektet që lidhen me përputhmërinë e Universitetit:

1. Këshillimi Akademik: Një aspekt i rëndësishëm i përputhmërisë është ofrimi i këshillimit akademik. Nëse studentët kanë lehtësi në përdorimin dhe qasjen e shërbimeve këshillimore, kjo mund të ndihmojë në përmirësimin e shkollimit dhe planifikimit të progresit akademik.
2. Planifikimi i Karrierës dhe Këshilla për Punësim: Shërbimet e planifikimit të karrierës dhe këshillimi për punësim, janë thelbësore për studentët që dëshirojnë të jenë të përgatitur për tregun e punës. Qëndrueshmëria dhe lehtësia në përdorim të këtyre shërbimeve mund të ndihmojnë studentët të bëjnë zgjedhje të duhura dhe të përgatiten për karrierën e tyre. Këshilltarët e karrierës ndihmojnë në hartimin e planeve të karrierës, përgatitjen për intervistat dhe krijimin e një CV. Pjesë e këshillimit akademik është të ofrosh këshillë dhe udhëzim për zhvillimin e një plani - karriere dhe përgatitjen për tregun e punës.
3. Shërbimet e Këshillimit Personal dhe Psikologjik: Lehtësia në përdorim të shërbimeve të këshillimit personal dhe psikologjik tregon se universiteti kujdeset për mirëqenien e

përgjithshme të studentëve. Ky aspekt mund të ndihmojë në menaxhimin e stresit dhe sfidave personale që mund të ndikojnë në përfshirjen dhe suksesin akademik.

Menaxhimi i të dhënave të studentëve gjatë regjistrimit, notimit, paraqitjes së provimeve, pagesave të taksave administrative deri në diplomimin e tyre, kryhen në formën elektronike përmes sistemit të menaxhimit universitar (SMU) gjithmonë duke e ruajtur privatësinë e informacionit.

Ndëshkimi i plagjiaturës bëhet duke iu referuar Kodit të Etikës, përkatësisht nenit 17, sipas të cilit plagjiaturë nënkupton aktin e përvetësimit ose kopjimit të një ideje, rezultatit, pune me shkrim ose ndonjë forme tjetër plotësisht ose pjesërisht, pa treguar burimin e përdorur. Të gjitha raportimet drejtuar Këshillit të etikës (i zgjedhur nga Senati i Universitetit), Komisionit disiplinor, apo komisionit ad-hoc (i caktuar nga Rektori i UKZ), shqyrton dhe merr vendimet përkatëse conform Statutit të UKZ dhe rregulloreve të UKZ.

Stafi akademik ka në disponim softëver për detektim të plagjiaturës, sikurse [plagiarismcheck.org](http://plagiarismcheck.org), [SAP \(SMU\)](http://SAP(SMU)), Google Class Room (Plagiarismcheck).

Programi do të ketë doracakun e Studentit, i cili është udhëzues i programit për studentët e sapo regjistruar. Ai do të jetë i botuar në uebfaqe të UKZ-së dhe poashtu do të jetë i qasëshëm kudo në objektin e UKZ-së, si broshurë që i ofrohet studentëve dhe atyre potencial pa pagesë. Doracaku i studentit përmban të gjitha të dhënat e përgjithshme dhe të veçanta që duhet ti ketë parasysh dhe duhet ti dijë një student i UKZ-së, duke përfshirë:

1. Informata të përgjithshme për UKZ-në dhe për stafin akademik e administrative të UKZ-së;
2. Programet studimore që ofrohen dhe akreditimi i tyre ndër vite;
3. Pjesë nga KdE dhe rregulloret disiplinore, të cilat duhet ti dijë studentit;
4. Pagesat që duhet të kryejnë studentët;
5. Zhvillimi i procesit mësimor dhe i aktiviteteve të tjera akademike;
6. Informata të tjera të nevojshme për studentët dhe jetën studentore;

Gjithashtu bazuar në Nenin 109 të Statutit të Universiteti të UKZ, studentët kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim te Dekani i njësisë akademike kundër notës që ai / ajo ka marrë.

Ankesa duhet të paraqitet brenda dy ditëve të punës pas shpalljes së rezultateve.

Pas marrjes së ankesës së paraqitur në kohë, Dekani i njësisë akademike formon Komisionin Shqyrtues brenda një dite pune pasi ankesa është marrë dhe emëron tre anëtarë, por pa mësimdhënësin, nota e të cilit po apelohej, për të siguruar paanshmërinë. Rastet e tilla trajtohen konform statutit dhe rregulloreve përkatëse. Në bazë të raportit të komisionit, ne mund të konfirmojmë paanësinë e këtij procesi në UKZ.

Kodi i Etikës dhe Rregullorja për Masat dhe procedurën disiplinore rregullojnë procedurën e përcaktimit të shkeljeve disiplinore të studentëve në UKZ, dmth. Vendosjen dhe përcaktimin e situatës faktike dhe shkelësin e supozuar, afatet për marrjen e masave, mbrojtjen e studentëve dhe ekzekutimin e disiplinës- masat.

Masat e mëposhtme mund të vendosen ndaj studentëve për shkelje disiplinore:

1. Vërejtje me shkrim,
2. Vërejtja e fundit me shkrim,
3. Përfshirja nga studimet deri në gjashtë muaj,

4. Përfundimi nga studimet për një vit.
5. Përfundimi nga studimet për dy vite
6. Përfundim përgjithmonë nga fakulteti

Sipas nenit 142 të Statutit të studentët kanë të drejtë të ankohen për cilësinë e procesit mësimor ose infrastrukturën universitare. Paraqitësi i ankesës duhet të paraqet fakte, argumente dhe prova të besueshme duke përmbledhur shkurtimisht arsyet për ankesë. Seanca për shqyrtimin e ankesave duhet të mbahet sa më shpejt që është e mundur po jo më vonë se 30 ditë, kur ankesa i drejtohet komisionit të ankesave. Komisioni duhet të vendosë brenda 60 ditëve prej ditës kur rasti i është paraqitur komisionit. Studentët e ndëshkuar për sjellje në kundërshtim me KdE në UKZ, kanë të drejtë të intervistohen nga komisioni disiplinor në nivel të UKZ, nga Komisioni i themeluar nga Senati. Studentët kanë të drejtë të kundërshtojnë - ankimojnë vendimin e Senatit – Universitetit në MASHT dhe në procedura gjyqësore.

Universiteti mundëson edhe [transferimin e studentëve](#), i cili bëhet përmes një thirrjeje publike, ku përcaktohen edhe kriteret të cilat duhet të përmbushin studentët që duan të realizojnë transferin nga universitetet tjera.

#### **Personeli Akademik dhe administrativ:**

Stafi akademik i programit ka përvojë akademike dhe shkencore të gjatë. Kanë marrë pjesë në konferenca shkencore vendore, regjionale dhe ndërkombëtare, duke publikuar artikuj dhe punime të tjera kërkimore-shkencore nëpër revista kredibile ndërkombëtare. Po ashtu stafi i është aktiv në projekte ndërkombëtare dhe merr pjesë vazhdimisht në vizita studimore, tryeza shkencore, debate publike.

Stafi i rregullt:

**Udhëheqësi i Programit Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe studimet evropiane (Ba) Prof. Ass. Dr. Selim Daku:** ka të përfunduar Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës, studimet e masterit në Universitetin e Evropës Juglindore në fushën e diplomacisë, ndërsa studimet e doktoratës në Fakultetin e Shkencave Politike, në Universitetin e Evropës Juglindore, në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare; ka publikuar punime shkencore në revista shkencore vendore dhe ndërkombëtare me impact faktor. Ka ligjëruar në Universitete jashtë Kosovës, si në Universitetin e Evropës Juglindore në Maqedoninë veriore, në Regent's University në Londër, Nova Lisboa University në Lisbonë, Universitetin Celal Bayar në Manisa të Turqisë dhe disa universitete të tjera vendore. Merr pjesë në projekte hulumtuese ndërkombëtare (Erasmu+, ICM). Ka udhëhequr disa kandidat në studimet master dhe ka marrë pjesë në komisione të ndryshme. Aktualisht është anëtarë i Këshillit Drejtues (organi më i lartë udhëheqës) të Universitetit Publik “Kadri Zeka”.

**Prof. asoc. dr. Urtak Hamiti,** ka kryer studimet në Prishtinë, ndërsa studimet e doktoratës në Universitetin e Tiranës ku mori titullin: Doktor i Historisë dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Ka punuar kabinetin e Kryeministrit të Kosovës si Këshilltar Politik, në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, si Drejtor për NATO dhe OSBE, dhe ka qenë diplomat i lartë i Kosovës në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Kroaci. Është ekspert në fushën e marrëdhënieve

diplomatiqe dhe të politikës së jashtme amerikane. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore, vendore dhe ndërkombëtare, si dhe ka publikuar punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare me impact faktor. Po ashtu, ka marr pjesë në mbrojtjen e programeve për çështjeve të akreditimit (AAK) në Universitetin e Gjilanit.

**Prof. Ass. Dr. Sylë Ukshini:** ka përfunduar studimet e Doktoratës në Fakultetin Juridik-Studime Evropiane në Universitetin e Bremani në Gjermani- studimet në drejtimin Marrëdhënie Ndërkombëtare në Fakulteti Juridik (UP) në nivelin master. Gjithashtu ka mbaruar studimet 4 vjeçare në drejtimin Histori në Universitetin e Prishtinës dhe studimet e Doktoratës në Fakultetin Histori dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranë –Dega e Historisë – Drejtimi Marrëdhënie Ndërkombëtare. Për shumë vite ka qenë Drejtor në Ministrinë e Jashtme të Kosovës; dhe shefi Misioni në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Tiranë. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare; ka publikuar punime shkencore në revista shkencore në Kosovë, Shqipëri, Turqi dhe vende të tjera evropiane. vendore dhe ndërkombëtare me impakt faktor. Ka ligjëruar në Universitete Prishtinës, në Kolegjin UBT dhe Victory. Aktualisht është Prof. Ass. në Fakultetin e Edukimit në UKZ. Është bashkëpunëtor Albania Institute for International Studies (AIIS) në Tiranë dhe i Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve (ITSH) – Shkup, si dhe është pjesë e projekteve të ndryshme hulumtuese ndërkombëtare. Ka udhëhequr disa kandidat në punimet e diplomës dhe ka marrë pjesë në komisione të ndryshme.

**Prof. Ass. Dr. Ardian Emini,** Studimet deridiplomike i ka kryer në Fakultetin Juridik në Universitetin Ndërkombëtar Sllavjan në Sveti Nikolla, Republika e Maqedonisë Veriore. Studimet e Masterit në Universitetin e Evropës Juglindore në Fakultetin Juridik, Drejtimi Civil, ndërsa studimet e Doktoratës në Universitetin Kirilli dhe Metodi në Shkup, Fakulteti Juridik Justininani i Parë – Fusha Juridik. Ka marrë pjesë në Konferenca vendore dhe ndërkombëtare me punime nga lëmi juridiko civil, ka punimet të publikuara në revistat shkencore të ranguar në platformën scopus me çrast shumica prej tyre kanë karakter civilo – juridik dhe atë historik të komponentës juridike. Aktualisht ligjeron në Universitetin “Kadri Zeka” Gjilan.

**Prof. asoc. dr. Dukagjin Leka:** Ka kryer studimet themelore në Fakultetin Juridik në Prishtinë dhe Fakultetin Filozofik – Shkenca Politike; studimet e masterit në departamentin e të drejtës ndërkombëtare në Prishtinë, ndërsa doktoratën në fushën Shkenca Juridike- Ndërkombëtare në Universitetin e Tiranës. Ka një përvojë prej një dekadë e gjysmë si ekspert në organizata ndërkombëtare dhe ka një karrierë të gjatë të punës në misionet ndërkombëtare si UNMIK dhe EULEX. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore me karakter vendor, regjional dhe ndërkombëtar si dhe ka publikuar 7 punime shkencore në revista shkencore me impact faktor. Ka publikuar një monografi shkencore nga fusha juridike ndërkombëtare. Ka realizuar disa projekte shkencore me karakter ndërkombëtar. Karriera e tij profesionale me trajnime të ndryshme është mjaft e bujshme, duke përmendur sidomos ato nëpër vende si ShBA-ja dhe vendet e Unionit Evropian. Gjithashtu, ka marrë pjesë në shumë konferenca shkencore rajonale dhe ndërkombëtare, duke vazhduar edhe më tutje me konsolidimin e tij në aspektin profesional e poashtu edhe shkencor. Ai tani ka publikuar disa artikuj shkencorë, kryesisht nga lëmia juridike, politike ndërkombëtare dhe sociale, ku një punim i tij është i indeksuar në Web of Science, katër punime në Scopus dhe disa punime tjera të indeksuara në platformat e tjera ndërkombëtare. Ai, ka qenë i angazhuar në disa universitete në Kosovë si ligjërues, si në

Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, dhe në Kolegjin AAB. Ai është njohës shumë i mirë i gjuhës Angleze dhe Serbo-Kroate dhe ka njohuri bazike të Gjuhës Frënge.

**Prof. Dr. Sadik Haxhiu**, ka kryer Fakultetin dhe studimet posdiplomike në Fakultetin Juridik Universitetin e Prishtinës. Ndërsa, studimet e doktoratës i ka përfunduar në Departamentin Kushtetues Administrativ në Universitetin e Bijaç-it në Bosnje dhe Hercegovinë në fushën e Sistemeve elektorale. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore vendore, regjionale dhe ndërkombëtare, si dhe ka publikuar punime shkencore me impact faktor. Ka hartuar mbi 5 tekste universitare dhe monografi. Ka marrë pjesë në dhjetëra komisione për hartimin e ligjeve në Kosovë, ku në disa prej tyre ka qenë kryetar komisioni. Ka udhëhequr (mentoruar) mbi 25 kandidatë në studimet master si dhe ka marrë pjesë në 2 komisione për mbrojtjen e doktoratës.

**Prof. Ass. Dr. Fatmire Krasniqi**: studimet themelore i ka kryer në Fakultetin Juridik po ashtu studimet e masterit në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës në drejtimin penal juridik me notë mesatare 10.00. Studimet e doktoratës në Fakultetin Juridik në Prishtinë në katedrën penale, ku mori titullin: Doktor i shkencave juridike - penale. Ka publikuar një monografi shkencore. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare si dhe ka publikuar punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare me impact faktor. Është profesore e lëndëve juridike penale.

**Prof. Asoc. Dr. Fadil Osmani**: ka kryer studimet themelore në Universitetin e Prishtinës Fakultetin Ekonomik duke i vazhduar studimet e masterit në Fakultetin Ekonomik në Prishtinë, fusha e Menaxhmentit, ndërsa, studimet e doktoratës i kreu në Universitetin e Tiranës në fushën e Ekonomisë, për Politika dhe Qeverisje në Evropë me temën: Integrimi në BE - Sfidë e Kosovës (aspekti Ekonomik, Politik dhe Juridik). Ka publikuar një monografi shkencore. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare si dhe ka publikuar punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare me impact faktor. Gjithashtu, ka një pervojë në disa universitete në Kosovë si ligjërues, si: në Universitetin e Biznesit në Gjakovë, Kolegjin “Globus” në Prishtinë dhe në Kolegjin AAB në Prishtinë dhe Ferizaj, si dhe ka mentoruar disa kandidat në studime master dhe Bachelor, në këto universitete. Karriera e tij profesionale është edhe e, zv.Kryetar i Këshillit Drejtues (bordit) të UP-se “Hasan Prishtina” në Prishtinë dhe tani staf i rregullt akademik, në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan. Aktualisht është anëtar i Këshillit Drejtues (organi më i lartë qeverisës) në UKZ.

**Prof. Asoc. Dr. Teuta Agaj**: Ka përfunduar studimet bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze në Kolegjin AAB në Prishtinë, Kosovë (2009), studimet master në Mësimdhënie të Gjuhës Angleze në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, Maqedonia e Veriut (2013) dhe studimet e doktoratës në Shkenca Filologjike - Gjuhë dhe Letërsi Angleze poashtu në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, Maqedonia e Veriut (2018). Ka 14 vite përvojë në mësimdhënie. Nga viti 2019 punon si profesoreshë e rregullt për lëndët e gjuhës angleze në Universitetin Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, Kosovë. Nga viti 2014 deri në vitin 2019 ka punuar si asistente e rregullt për lëndët e gjuhës angleze në Universitetin Publik “Kadri Zeka” në Gjilan. Nga viti 2016 deri në vitin 2023 ka ligjëruar lëndët "Sintaksa e Gjuhës Angleze I", "Sintaksa e Gjuhës Angleze II", "Morfologji e Gjuhës Angleze", "Hyrje në Gjuhësi", "Struktura e Anglishtes Moderne", "Përvetësimi i Gjuhës së Parë dhe të Dytë" dhe "Historia e Gjuhës

Angleze" në Universitetin publik "Ukshin Hoti" në Prizren, Kosovë. Nga viti 2012 deri në vitin 2016 ka ligjëruar lëndët "Sintaksa e Gjuhës Angleze I" dhe "Sintaksa e Gjuhës Angleze II" në kolegjin AAB në Prishtinë, Kosovë. Nga viti 2009 deri në vitin 2014 ka ligjëruar lëndën 'Gjuhë Angleze' në shkolla publike fillore dhe të mesme si dhe në shkolla private të gjuhës angleze. Ka një monografi të botuar dhe një kapitull në një monografi me bashkautorë. Ka botuar një sërë artikujsh shkencorë në revista shkencore dhe gjithashtu ka marrë pjesë në disa konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Ka marrë pjesë në shumë programe trajnimi dhe projekte. Ka ligjëruar në Universitetin e Zug-ut (Zvicër), në kuadër të mobilitetit akademik.

### **Stafi i angazhuar:**

**Dr. Sc. Blerim Haziri** ka kryer Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës drejtimi Histori-Ed. Qytetare, studimet e masterit mbaroi në Fakultetin Filozofik në degën e Historisë, ndërsa studimet e Doktoratës mbaroi në Fakultetin e Shkencave Shoqërore Bashkëkohore-drejtimi Shkenca Politike pranë Universitetit të Evropës Juglindore. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare; ka publikuar punime në revista shkencore vendore dhe ndërkombëtare me impact factor. Gjithashtu, vazhdimisht boton dhe merret me organizime të karakterit shkencor në nivel vendi.

**Dr. sc. Avni Rudaku** ka kryer studimet universitare për psikologji (2006) dhe për sociologji (2008). Më pas, kreu studimet master (2012) dhe studimet e doktoratës për sociologji në janar të vitit 2024, në Universitetin Publik "Hasan Prishtina" në Prishtinë. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore ndërkombëtare dhe ka publikuar artikuj në revista shkencore ndërkombëtare. Është autor i katër librave të natyrës letrare, publicistike dhe sociologjike. Është autor i disa audiodokumentarëve për trashëgimi kulturore dhe historike. Ka marrë pjesë në trajnime dhe ka qenë menaxher i projektit QATEK në kuadër të ERASMUS-it. Ka përvojë të gjatë në shoqëri civile, duke qenë pjesë aktive e shumë organizimeve dhe aktiviteteve kulturore. Ka përvojë të gjatë në mësimdhënie parauniversitare si mësimdhënës dhe atë universitare si asistent i angazhuar që nga viti 2009. Jeton dhe vepron në Gjilan.

**Dr. Sc. Shpresa Kaciku- Balija:** Dr. Shpresa Kaçiku Baljija ka kryer studimet baçelor dhe master në Departamentin e Shkencave Politike në Universitetin e Prishtinës, ndërsa studimet e doktoratës i ka përfunduar në Universitetin e Evropës Juglindore, në fushën e qeverisjes dhe administratës publike. Ka specializuar me diplomë ndërkombëtare në Universitetin e Kalifornisë Berkeley në studime për menaxhim dhe lidhshmëri. Ka ligjëruar si Professore Asistente në programe baçelor të shkencave politike dhe asistente/bashkepunetore e jashtme në programin master Qeverisje Lokale dhe Shoqëri Demokratike. Dr. Shpresa Kaçiku Baljija ka publikuar artikuj shkencorë në revista të mirënjohura ndërkombëtare. Është publikuar në procedime të konferencave shkencore dhe autore/eksperte në raporte politikash nga institucionet publike. Ka prezantuar punën kërkimore në shumë konferenca shkencore ndërkombëtare dhe është anëtare në disa asociacione ndërkombëtare shkencore. Dr. Shpresa Kaçiku Baljija ka shërbyer si eksperte dhe konsulente për organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe ka një eksperiencë 15 vjeçare në menaxhim të projekteve të organizatave ndërkombëtare për zhvillim të kapaciteteve të institucioneve të administratës publike në Republikën e Kosovës.

PERSONELI I RREGULLT AKADEMIK					
Nr.	Emri dhe mbiemeri	Grada shkencore	Titulli akademik	Fusha e studimit	Kohëzgjatja e kontratave
1.	Selim Daku	Dr. sc.	Prof. Ass.	Shkenca Politike (organizatat ndërkombëtare)	4 vite
2.	Urtak Hamiti	Dr. sc.	Prof. Asoc.	Marrdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci	4 vite
3.	Sylë Ukshini	Dr. sc.	Prof. Ass.	Studime evropiane	4 vite
4.	Ardian Emini	Dr. sc.	Prof. Ass.	Shkenca juridike nga historia e së drejtës	4 vite
5.	Dukagjin Leka	Dr. sc.	Prof. Asoc.	Shkenca juridike – fusha studime evropiane dhe legjislacion	4 vite
6.	Sadik Haxhiu	Dr. sc.	Prof. Dr.	Shkenca juridike – fusha kushtetuese-administrative	Pa afat
7.	Fatmire Krasniqi	Dr.sc.	Prof. Ass.	Shkenca juridike – fusha penale	4 vite
8.	Fadil Osmani	Dr.sc.	Prof. Asoc.	Integrimi në BE - Sfidë e Kosovës - aspekti ekonomik, politik dhe juridik	4 vite
9	Teuta Agaj	Dr. sc.	Prof. Asoc.	Gjuhë dhe letërsi angleze	4 vite

Tabela 1. Fusha e studimit të personelit të rregullt akademik në program

PERSONELI I ANGAZHUAR AKADEMIK					
Nr.	Emri dhe mbiemeri	Grada shkencore	Titulli akademik	Fusha e studimit	Kohëzgjatja e kontratave
1.	Blerim Haziri	Dr. sc.	Ligjërues i angazhuar	Shkenca Politike	Semestrale
2.	Avni Rudaku	Dr. sc.	Ligjërues i angazhuar	Sociologji	Semestrale
3.	Shpresa Kaciku-Balija	Dr. sc.	Ligjërues i angazhuar	Qeverisje dhe administrate publike	Semestrale
4.	Viona Rashica	Dr.sc.	Asistente e angazhuar	Shkenca Politike	Semestrale
4.	Phd.c. Shpresave Veseli Dragobuzhda	Phd.c.	Asistente e angazhuar	Gjuhë dhe letërsi angleze	Semestrale
5.	Phd.c. Lulzim Ramiqi	Phd.c.	Ligjërues i angazhuar	Gjuhë Gjermane	Semestrale

Tabela 2. Fusha e studimit të personelit e personelit të angazhuar akademik në program

Në tabelat e mësipërme është stafi në marrëdhënie të rregullt pune si dhe bashkëpunëtorët e potencial për angazhim. Shumica e tyre kanë përvojë akademike të gjatë dhe të suksesshme nëpër universitetet publike brenda Kosovës dhe jashtë saj. Përveç ligjërimit në studimet themelore bachelor, ata kanë përvojë edhe në programet master dhe doktoratë, varësisht prej profilit të tyre.

Duke pasur parasysh se jemi në fazën e konsolidimit të Fakultetit të Shkencave Sociale, konform akteve normative në fuqi, si Statutit të Universitetit dhe [Rregullores për zgjedhjen e personelit të rregullt akademik](#), në vitin e ardhshëm akademik do të rekrutojmë personel të ri akademik. Së pari Këshilli i Fakultetit identifikon nevojat për personel të rregullt akademik, asistent apo profesor; debatohet në Këshillin mësimor shkencor dhe i njëjti aprovohet, me pas me një arsyetim të bazuar siç janë fondi i orëve që duhet të plotësohet dhe qëndrueshmëria financiare, i bënë kërkesë Senatit të Universitetit për miratim.

Pas miratimit nga ana e Senatit të Universitetit, Rektori i Universitetit bënë shpalljen publike për rekrutimin e profesorëve/asistentëve të rregullt. Në konkurs duhet të specifikohen në mënyrë të detajuar kushtet që duhet t'i plotësoj një kandidat për t'u zgjedhur profesor i rregullt në universitet siç janë: kualifikimet profesionale deri te thirrja shkencore doktor i shkencave, pjesëmarrje në konferenca shkencore, vendore dhe ndërkombëtare; Punimet shkencore me impakt factor (konform UA MASHT, nr.01/2018) si dhe kontributet tjera akademike dhe profesionale. Konkursi është i hapur dhe ai publikohet në uebfaqe dhe mjetet tjera të informimit, duke iu mundësuar kandidatëve një konkurrencë të barabartë.

Këshilli i fakultetit pas shpalljes së konkursit publik, propozon Komisionin Recensues prej tre profesorëve të cilët duhet të kenë thirrje relevante akademike. Komisioni Recensues pasi shqyrton dokumentacionin e kandidatëve konkurrues, ata kandidatë që i plotësojnë kushtet formale juridike, i fton në intervistë. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni Recensues i harton raportet për secilin kandidat dhe pastaj përmes Zyrës së Personelit e shpallë rezultatin e kandidateve në buletin, në Web faqe të Universitetit. Pas përfundimit të ekspozimit të recensioneve përmes buletinit në Web faqe, Këshilli i Fakultetit, raportet recensuese ua dërgon Komisionit të Studimeve të Universitetit.

Komisioni i Studimeve ka për detyrë të vlerësoj përmbajtjen, ligjshmërinë, objektivitetin e punës së Komisionit Recensues si dhe vlerësimin e kontributeve shkencore dhe profesionale të kandidatëve konkurrent. Komisioni i Studimeve bënë një raport të vlerësimit të kandidatëve dhe ja dërgon Senatit për shqyrtim dhe miratim. Senati pastaj pas debatit profesional merr vendim për zgjedhjen/moszgjedhjen e kandidatit për profesor ose asistent. Pas votimit në Senat, emërimi i profesorit/asistentit, të zgjedhur bëhet për periudhën 4 vjeçare; asistentët për periudhën 3 vjeçare ndërsa ligjëruesit për periudhën 3 vjeçare.

Stafit akademik i ofron mundësi për të avancuar njohuritë e tyre të [mësimdhënies dhe metodologjisë shkencore](#), poashtu ofrohen trajnime për [hartim të projekteve](#). Këto aktivitete ndikojnë në zhvillimin e gjithmbarshëm, azhurnimin e njohurive dhe përmisimin e performancës së stafit akademik. Poashtu trajnime ofron edhe për programe të tjera trajnimi, sikurse ato të përdorimit të [teknologjisë dhe aplikacioneve të nevojshme universitare](#).

Bazuar në [ligjin e punës](#), i punësuarit në momentin që mbush 65 vjet, arrin moshën e pensionimit. Kjo rregull vlenë edhe për stafin akademik të UKZ-së. Në raste të veçanta profesorët e pensionuar mund të angazhohen për mësimdhënie deri në moshën 70 vjeçare.

Në kuadër të stafit administrativ, zyrtari Betim Berisha është caktuar me vendim të sekretarit të përgjithshëm në pozitën e koordinatorit të cilësisë në Fakultetin e Shkencave Sociale(FSHS).



## **Cilësia:**

Sistemi i sigurimit të Cilësisë në UKZ përbën një gamë të gjerë të gjithëpërfshirjes së politikave të sigurimit të cilësisë në nivel institucional duke përfshirë të gjitha proceset zhvillimore të institucionit mbi bazën e planifikimit dhe koordinimit me mekanizmat e brendshme dhe të jashtme të cilat orientojnë zhvillimin e vazhdueshëm të politikave për sigurim të cilësisë. Sistemi i sigurimit të cilësisë në universitet mbështetet në tri shtylla kryesore: Dokumente, organe dhe instrumente për vlerësim të cilat kontribuojnë në arritjen e objektivave drejt përmbushjes së misionit të UKZ-së.

Në kuadër të vlerësimit të cilësisë në universitet, UKZ ka ngritur kapacitetet duke emëruar Prorektorin për Zhvillim Akademik dhe Cilësi. Gjithashtu në vitin 2022 në kuadër të ZZHAC ka rekrutuar një zyrtare për Akreditim si dhe një zyrtare për Zhvillim në Karriere dhe Alumni. Në tetor të 2021 ZZHAC në bashkëpunim me KMCV – në ka hartuar Kalendarin Vjetor për Sigurim të Cilësisë përmes të cilit janë planifikuar të gjitha aktivitetet për SC, të mbështetura në kornizën normative.

Në vitin 2023 UKZ ka miratuar politikat e reja për sigurim të cilësisë duke bërë rishikimin e të gjitha dokumenteve të aprovuara më 2020. Përmes këtyre masave është arritur që të bëhet plotësimi i dokumenteve duke u bazuar në rekomandimet e KMCV për përmirësime aty ku është hasur në vështërsi të zbatimit. Përmes rishikimit të politikave për sigurim të cilësisë është arritur që dokumentet të bëhen më praktike dhe më të qasshme për realizim. Janë definuar të gjitha proceset, mekanizmat, instrumentet, raportimet grumbullimet e të dhënave, afatet kohore si dhe të gjitha përgjegjësitë e individëve dhe njësisive të përfshira në proces.

Zbatimi i tërë sistemit të sigurimit të cilësisë në UKZ realizohet duke u mbështetur në këto dokumente: Statutin e UKZ së, Planin Startegjik, Rregulloren për Sigurim të Cilësisë, Manualin për Planifikim dhe Vlerësim të Performancës, Treguesit Kryesor të Performancës dhe Udhëzuesit e ECTS (të rishikuara 2023). Përmes Rregullores për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësimit definohet sistemi i sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit, mekanizmat, instrumentet, akterët e sigurimit të cilësisë, gjithashtu rregullorja përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e palëve të përfshira në këtë proces.

Gjithashtu që nga viti 2020 UKZ ka nxjerrë edhe [rregulloren për funksionimin e Këshillit Mbikqyrës për Cilësi dhe Vlerësim](#) Nr. 01/2913 dt. 18.12.2023 e cila përcakton mënyrën e funksionimit të këtij organi. KMCV është një organ këshillues, i cili në bashkëpunim me organet e tjera profesionale të UKZ, planifikon, harton, monitoron, analizon dhe administron procedurat e vlerësimit të procesit mësimor, hulumtimit shkencor dhe të gjitha vlerësimet e fushave të tjera që mbulohe nga UKZ.

Vlerësimi i performancës së SA në UKZ zhvillohet përmes Manualit për Planifikim dhe Vlerësim të Performancës (MPVP) i cili në aspektin institucional është i rëndësishëm për të planifikuar, monitoruar, vlerësuar, zhvilluar dhe afirmuar përsosmërinë e performancës në përmbushjen e misionit dhe objektivave të UKZ, përmirësimin e shërbimeve ndaj shoqërisë dhe studentëve përmes mësimdhënies cilësore, përmirësimin e kurrikulave dhe programeve studimore; mundëson harmonizimin e objektivave të performancës se stafit akademik me standardet e performancës të përcaktuara nga Agjencia Kosovare e Akreditimit, si dhe

identifikimin e nivelit të kompetencave të stafit akademik në fushën e kërkimit dhe kushtet për punën e tyre kërkimore që ofron UKZ.

UKZ nëpërmjet instrumenteve të vlerësimit bën matjen e cilësisë në disa dimensione duke përdorin një numër të konsiderueshëm të pyetësorëve:

1. Pyetësi për studentë lidhur me shërbimet administrative në UKZ
2. Pyetësi për studentë lidhur me vlerësimin e Profesorëve të UKZ
3. Pyetësi për studentë lidhur me vlerësimin e asistentëve të UKZ
4. Pyetësi për vetëvlerësim të stafit akademik
5. Pyetësi për vlerësim Dekani- Mesimdhënësin
6. Pyetësi për vlerësim Sekretari –Zyrtarët Administrativ
7. Pyetësi për alumni
8. Pyetësor për studentët para diplomimit
9. Pyetësor për studentët që braktisin studimet në UKZ
10. Pyetësi për vlerësim të jashtëm/ punëdhënësi

UKZ duke u mbështetur në cilësinë e rezultateve nga raportet e vlerësimit në vazhdimësi bën rishikim metodologjisë së vlerësimit duke bërë modifikim të instrumenteve për vlerësim më qëllim që sa më shumë të rritet cilësia e vlerësimit.

Pasi sigurimi i cilësisë në UKZ është i pavarur dhe realizohet përmes një procesi të centralizuar, duke garantuar objektivitet të lartë, të gjitha këto rregulla, organe, procedura dhe instrumente vlejné edhe për programin e studimit marrëdhëniet ndërkombëtare dhe studimet evropiane.

Skema në vijim pasqyron në mënyrë të plotë të sistemit të sigurimit të cilësisë në UKZ.




Figura 1: Sistemi i Sigurimit të Cilësisë në UKZ

Proceset e sigurimit të cilësisë në UKZ menaxhohen nga Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi e cila është funksionale që nga viti 2018. Zyra përbëhet nga Drejtori, zyrtari për Akreditim si dhe zyrtari për Zhvillim në Karrierë dhe Alumni.

ZZhAC koordinon punën në mbështetje të njësive akademike për procesin e vlerësimit të performancës së stafit akademik si dhe me procesin e akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve, duke përfshirë të gjitha aktivitetet që përfshijnë këto procese dhe poashtu koordinon punën e zyrës me zyrën e Prorektorin për Zhvillim Akademik dhe Cilësi, me Senatin, Këshillat e Fakulteteve, komisioneve dhe grupeve të tjera punuese.

Këshilli Menaxhues për Cilësi dhe Vlerësim (KMCV) përbëhet nga Prorektori për Zhvillim Akademik dhe Cilësi i cili është edhe kryesues, nga prodekanët e pesë NJA, një zyrtarë nga Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi, Zyra për Çështje Akademike si dhe dy studentë përfaqësues, gjithsej dhjetë anëtarë.

Gjithashtu, në bashkëpunim me Zyrën për Zhvillim Akademik dhe Cilësi, programi do të caktoj koordinatorin për Cilësi, i cili/cila ka detyra dhe përgjegjësi të rëndësishme në rrafshin e të siguruarit të cilësisë brenda programi marrëdhëniet ndërkombëtare dhe studimet evropiane. Koordinatorin e Cilësisë, anëtar i stafit akademik, është urë lidhëse në mes njësive akademike dhe ZZhAC. Ai i raporton menaxhmentit dhe KF.

Koordinatori i Cilësisë ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Udhëzon stafin akademik dhe studentët në kuadër të njësive akademike lidhur me aspektet praktike dhe akademike të zbatimit të ECTS-së;

- Në bashkëpunim me menaxhmentin e njësisë akademike, përkujdeset dhe monitoron përfshirjen e të gjitha palëve me interes (stafi akademik, studentëve, bizneseve, anëtarëve të Bordit këshillëdhënës, etj.), për hartimin/rishikimin e programeve të studimit gjatë procesit të ri/akreditimit;
- Është pjesë e planifikimit dhe monitorimit të procesit të vlerësimit të lëndëve dhe mësimdhënësve, si dhe vlerësimit të brendshëm të cilësisë;
- Në bashkëpunim me menaxhmentin e njësisë akademike ndihmon në sistemimin e të dhënave dhe informatave lidhur me aktivitetin shkencor/artistik në njësinë akademike (evidentimin e punimeve shkencore, performancës artistike, projekteve profesionale dhe shkencore);
- Këshillon, planifikon, dhe monitoron skema, aktivitete dhe veprimtari për ngritjen e cilësisë në njësinë akademike. Po ashtu, Koordinatorin kujdeset për cilësinë e dokumenteve dhe informacioneve nga fusha akademike e fakultetit të publikuara në Ueb-faqe.

Rezultatet e vlerësimeve të brendshme dhe raportet e hartuara nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë shërbejnë si udhërrëfyes për ndryshime drejt përmirësimit të cilësisë së programit.

Në Objektivin strategjik 5. Zhvillimi i praktikave efektive menaxheriale në Planin Strategjik 2023/2028 përveç objektivave është përcaktuar edhe rishikimi i rregullave, organeve dhe proceseve, kompetencave sipas praktikave bashkohore në mënyrë që të avancojmë procesin e ngritjes së cilësisë nëpër programe studimore.

Sigurimi i cilësisë në UKZ, mbështetet edhe nga projekte të ndryshme ndërkombëtare në të cilat është partner UKZ siç janë: QATEK (Erasmus+), Research Cult, HERAS.

Sistemi i sigurimit të cilësisë mbulon aktivitete në programin studimor, për sigurim të cilësisë ku përfshihet planifikimi, zbatimi, vlerësimi dhe rishikimi. E gjithë kjo mbështetet në dokumentacionet në fuqi, në mënyrë të detajuar këto aktivitete janë paraparë në Kalendarin Vjetor për Sigurimin e Cilësisë.

Në UKZ, në kuadër të Kalendarit vjetor për sigurim të Cilësisë janë planifikuar të gjitha aktivitetet për sigurim të Cilësisë që përfshijnë edhe vlerësimet e rregullta të shpërndara nëpër javë përgjatë tërë vitit akademik nga shtatori deri në korrik.

Në fund të vitit hartohet raporti i mbikëqyrjes mbi të cilin ZZHAC dhe KMCV rekomandon përditësimin e Kalendarit Vjetor për sigurim të Cilësisë.

Nga viti 2020, Stafi Akademik përmes Planit Zhvillimor Individual, çdo fillim viti bën planifikimin e punës së tyre në disa dimensione i cili përfshin 4 objektiva e të cilat janë: Procesi Mësimor, Punë kërkimore-shkencore/Vepra artistike, Shërbimet menaxheriale, Shërbimet për shoqëri.

Në fillim të çdo viti akademik, nga Koordinatorin i Cilësisë së NJA bëhet mbikëqyrja e realizimit të PZHI, vlerësimi përfundimtar i dorëzohet Dekanit, kështu PZHI bën pjesë në vlerësimin e performancës së SA dhe për çdo vit bëhet planifikimi i ri nga SA.

Gjate shqyrtimit të raporteve analizohet cilësia e rezultateve dhe bëhen ndërhyrjet e nevojshme për rishikim të pyetësorve që të shërbejnë për të ardhmen për vlerësime sa më objektive.

[Për të gjitha vlerësimet hartohen raporte të veçanta si në vijim:](#)

1. Raport Vlerësimi i SA si dhe lëndëve nga ana e studenteve për semestrin dimëror
2. Raport Vlerësimi i SA si dhe lëndëve nga ana e studenteve për semestrin veror
3. Raport Vetëvlerësimi nga Mësimdhënësit
4. Raport Vlerësimi i Shërbimeve Administrative nga ana e studentit
5. Raport Vlerësimi i Programeve të UKZ-së nga Alumni
6. Raport Vlerësimi i UKZ-së nga Punëdhënësit
7. Raport Vlerësimi për student para diplomimit
8. Raport Vlerësimi për studentët që braktisin studimet në UKZ
9. Raport Vlerësimi për vlerësim të jashtëm/ punëdhënësi
10. Raport Vlerësimi i Kalendarit Vjetor për sigurim të cilësisë

Kështu vlerësimet janë pjesë e rishikimit të performancës së aktiviteteve të përditshme si dhe objektivave strategjike të përcaktuara me rregullativën për sigurim të cilësisë që u ofron një mundësi për të reflektuar. Nga rezultatet e marra, mekanizmat që punojnë në sigurim të cilësisë marrin parasysh inputet, sygjerimet, pastaj kjo reflektohet në përmirësime të vazhdueshme të planifikimit.

ZZhAC, ka krijuar një bazë me të dhëna të grumbulluara nga vlerësimet përgjatë viteve. Këto të dhëna janë të disponueshme për të gjitha palët e interesit. ZZHAC-ja, posedon të dhënat si në vijim:

- **Materialet e dorës së parë** (Pyetësorë: Kopje fizike dhe elektronike)
- **Rezultatet e hulumtimeve** (Rezultatet e përgjithshme për institucionin, njësitë akademike dhe personelin akademik dhe administrativ)

UKZ-ja posedon këto lloje të raporteve:

1. Raportet nga hulumtimet në formë fizike
2. Raporte në formë elektronike
3. Raportet nga SMU
4. Raportet nga Moodle
5. Raportet nga UKZ platforma
6. Raportet nga Google Form
7. Raportet nga aparati i vijueshmërisë

Në përfundim të secilit semestër dhe gjithashtu në mbyllje të çdo viti akademik, brenda çdo Fakulteti, do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të UKZ-së një Raport Përmbledhës për Vlerësimin e Stafit Akademik dhe lëndëve. Ky raport do të përfshijë një analizë të hollësishme të arriturve dhe sfidave për semestrin ose vitin akademik të përfunduar. Kjo praktikë jo vetëm që motivon stafin akademik, por gjithashtu ndihmon në identifikimin e sfidave potenciale, me qëllim që ato të adresohen dhe eliminohen në të ardhmen.

Instrumentet për Vlerësim të performancës së stafit akademik dhe administrativ realizohen duke u bazuar në [Manualin për Planifikim dhe Vlerësim të Performancës së SA](#) Nr. 01/2912 dt. 18.12.2023. Gjatë analizës së rezultateve KMCV, janë diskutuar përgjigjet dhe rrjedhimisht janë propozuar ndryshimet në pyetësor me qëllim të arritjes së rezultateve të synuara. Për Vlerësimin e SA nga ana e studentëve, gjatë kësaj periudhe është përdorur një format

përafërsisht i njëjtë me disa ndryshime të propozuara nga KMCV. Ndryshime më të theksuara janë bërë në pyetësonin për Vlerësimin e Administratës nga ana e studentëve, vlerësimin e palëve të interesit të cilët kanë vlerësuar studentët tanë të diplomuar. Pra, UKZ ka bërë standardizimin e pyetësorëve për fushat me interes për vlerësim.

Rezultatet e vlerësimit analizohen nga ZZhAC dhe nga Këshilli për Mbikëqyrjen e Cilësisë dhe Vlerësim. Te dhënat e të gjitha anketimeve grumbullohen, përpunohen me softuer adekuat dhe publikohen në uebfaqe. Krahasimet bëhen për të shikuar trendin e zhvillimit, në mënyrë që të ndërmarë masat për përmisim të mëtejshëm.

Raportet e rezyмуara bëhen publike edhe në uebfaqen e UKZ dhe raportohen edhe në Senatën e Universitetit, ndërsa raportet me detaje për secilin staf i raportohen Dekanit të Fakultetit dhe vetë stafit konkret.

Të gjitha këto vlerësime (anketa, pyetësorë etj.) ruhen në Zyrën për Zhvillim Akademik dhe Cilësi, ndërsa raportet e kësaj Zyre arkivohen dhe ruhen në Arkivin e UKZ, sipas Ligji Nr. 04/L-088 Për Arkivat Shtetërore.

Udhëheqësi i programit, pas përfundimit të çdo semestri, do të posedojë Raportet e Vlerësimit, të cilat përmbajnë të dhëna për secilin staf akademik të rregullt dhe të angazhuar, si dhe për stafin administrativ. Këto të dhëna po ashtu shërbejnë dhe përdoren si një indikator në procesin e avancimit dhe të angazhimit të stafit akademik dhe administrative.

Programi ka paraparë që të shtohet edhe një instrument i ri i vlerësimit, ku profesori do të vlerësojë studentët që kanë ndjekur lëndën e tij. Kjo do të mundësojë që të kemi një pasqyrë edhe më shtesë për nivelin e angazhimit të studentëve në lëndë të caktuara.

Gjithashtu, në kuadër të Universitetit për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë merren parasysh:

- Mbikëqyrja e rregullt e aparatit për evidentim të hyrje-daljeve të stafit akademik dhe administrativ;
- Këshillat e Fakulteteve në vazhdimësi evidentojnë dhe përmirësojnë programet e studimeve, bazuar në nevoja, duke gjetë mbështetje në rregulloren për studimet bachelor, master dhe duke u bazuar në udhëzuesin administrativ të AKA-së (15/18);
- Programet studimore kanë të inkuorporuar praktikat profesionale si pjesë e programeve të studimit;
- Këshillat e Fakulteteve miratojnë ndryshimet e syllabusëve të lëndëve si dhe hartimin e tyre sipas taksonomise së Blumit;
- Është bërë riorganizimi i administratës, që ka bërë që të përmirësohen shërbimet administrative për studentë;
- Përmes SMU vlerësohen studimet në UKZ nga studentët paradiplomimit (pasi përfundojnë të gjitha provimet);
- Përmes SMU vlerësohen arsyet e braktisjes së studimeve;
- Çdo vit akademik mbikëqyret suksesi (kalueshmëria) e studentëve.

Çdo vlerësim i bërë i dërgohet në mënyrë individuale dhe elektronike stafit akademik dhe ky vlerësim ju shërben atyre dhe stafit drejtues të UKZ për të reflektuar dhe për të vlerësuar se në çfarë gjendje është UKZ sa i përket cilësisë së procesit të mësimit. Pas përpunimit të të dhënave, ZZHAC në bashkëpunim me KMCV, analizon të dhënat, nxjerr rekomandimet dhe harton raportin e gjetjeve. Në kuadër të kësaj, akterët përgjegjës për sigurim dhe vlerësim të cilësisë ndërmarrin hapa për rishikimin e instrumenteve vlerësuese, duke u bazuar në rezultatet dhe inputet e raporteve.

Rregullimet e sigurimit të Cilësisë Vetëvlerësohen, raportohen dhe përmirësohen rregullisht për të siguruar standardet dhe efikasitetin e tyre në kohë. Sistemi i sigurimit të cilësisë në vazhdimësi ka mbikëqyrje nga KMCV, ZZhAC-ja, Njësitë Akadematike, Senati dhe KD i UKZ-së. Të gjitha këto organe në baza të rregullta mbikëqyrin zhvillimin e planit strategjik të UKZ-së përmes Planit të Veprimit duke evidentuar sfidat të cilat hasen gjatë realizimit të aktiviteteve të parapara. Poashtu, Plani Strategjik i UKZ-së është miratuar nga Këshilli Drejtues për periudhën 2023-2028 i cili përmban pesë objektiva strategjike të cilat në fokus e kanë ngritjen e cilësisë.

### **Infrastruktura dhe pajisjet:**

Universiteti ka një sipërfaqe e cila i plotëson nevojat e programit Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe studimet evropiane. Kampusi ekzistues përbëhet prej dy objekteve të mëdha, të ndërlidhura midis tyre dhe të përshtatshme për aktivitete mësimore. Gjendet në një pozitë të përshtatshme, brenda qytetit, me një mundësi të përshtatshme për qasje nga studentët dhe stafi. Objekti kryesor ka një hapësirë prej 6500 m<sup>2</sup> për zyrat e stafit akademik dhe administrativ, sallat e mësimit, laboratorët, kabinetet, bibliotekën dhe infrastrukturën tjetër të paraqitur në tabelën 1 dhe 2, ndërsa komplet Kampusi i UKZ-së në total ka një hapësirë prej 2ha ose 20000 m<sup>2</sup>. UKZ, bashkë me Komunën e Gjilanit dhe me Qeverinë e Kosovës është duke planifikuar zgjerimin e kampusit aktual edhe me një objekt të madh apo ndërtimin edhe të një kampusi të ri, ose zgjerimin e kampusit ekzistues.

UKZ ka një objekt, i cili përbëhet nga salla mjaft cilësore, me mjete teknologjike më të reja, si Smart Board, Projektor dhe pajisje tjera teknologjike, pastaj shpërndarja e Laptopëve për profesorë, etj.

Universiteti Publik “Kadri Zeka” ka siguruar e MS365 (programet nga paketa e Microsoft Office). Licencat janë në kohëzgjatje tre vjeçare (Nëntor 2023 – Nëntor 2026) dhe mundësohen nga Qeveria e Kosovës/Ministria e Ekonomisë përmes projektit KODE, për të gjithë stafin akademik, administrativ dhe studentët. Stafi i universitetit ka qasje edhe në softuer të ndryshëm, gjithashtu ofrohen softuer të tjerë të cilët janë Open Source. Sistemi i Menaxhimit Universitar – SMU është platforma përmes të cilës automatizohen dhe optimizohen të gjitha proceset e lidhura me studimet. UKZ përdor platformën E-learning (Moodle). Universiteti ynë përdor platformën Guide for Education për të përmirësuar përvojën e mësimit dhe bashkëpunimit në mes studentëve, personelit akademik dhe personelit administrativ. [Universiteti përdor edhe databzat e përmendura në pjesën e Hulumtimit për](#)

## qasje në burime shkencore.

Inventari i UKZ menaxhohet, monitorohet dhe shpërndahet sipas kërkesave të aprovuara. Zyrtarja e Pasurisë dhe Zyrtarja e Depos kujdesen për inventarin. Për menaxhimin e inventarit përdoret sistemi e-Pasuria.

UKZ është universitet publik dhe financohet nga Buxheti i Kosovës. MASHT cakton tarifat e shkollimit. UKZ harton Buxhetin e vet në konsultim me MASHT dhe Ministrinë e Financave, dhe i njëjti miratohet në kuadër të Ligjit të Buxhetit të Kosovës. Plani i financimit të programit aktual është pjesë e planit të financimit të UKZ si dhe planit të prokurimit të bashkëlidhur si shtojcë. (shih: Plani financiar 2024, Plani i Prokurimit 2024 UKZ).

Programi aktivitetin do ta zhvilloj në kampusin qendror të Universitetit. Hapësirat për zhvillimin e veprimtarisë së programit janë të mjaftueshme dhe plotësojnë kriteret e nevojshëm për veprimtarinë e programit. Kampusi i UKZ është në rrugën “Zija Shemsiu”, në qendër të Gjilanit. Ai përbëhet prej dy objekteve të mëdha, të bashkuara në rikonstruktim. Kampusi është në kufi me Kampusin e Shkollave të Mesme të qytetit, duke e shndërruar gjithë zonën në zonë shkollore, dhe universitare. Kampusi nuk i plotëson të gjitha nevojat në zhvillimin dinamik të UKZ, prandaj UKZ në bashkëpunim me Komunën e Gjilanit dhe Qeverinë e Kosovës kanë gjetur një zgjidhje për një kampus të ri të universitetit, e bërë kjo përmes [zotimit të Kryetarit të Komunës së Gjilanit](#). E cila do të finalizohet përmes vendimit të KK. Gjilan. UKZ po ashtu edhe brenda kampusit të tashëm në vitin 2020-2023 ka shtuar hapësira të reja mësimore dhe bibliotekare.

Sa i përket numrit të ulëseve në sallat ku mbahen ligjëratat, seminarët etj, janë të mjaftueshme për grupet e studenteve të programit, duke përfshirë kurrikulat sipas plan programit mësimorë. Universiteti është i pajisur me pajisje solide për mbajtjen e ligjëratave dhe ushtrimeve.

Struktura e hapësirave për ligjëratat është e shpërndarë në dy hyrjet e objektit të UKZ-së: A dhe B. Kjo shpërndarje është si në vijim:

<b>Hyrja A</b>		<b>Hyrja B</b>	
Salla nr.	Nr. i ulëseve	Salla nr.	Nr. i ulëseve
A/01	110	B01	100
A/02	120	B02	100
A12	70	B03	30
A13	LAB.BSHN	B04	30
A14	70	B10	Kabinet IT/30
A21	35	B11	150
A22	70	B12	Kabinet IT/30
A23	40	B13	40
A24	Kabinet Muz 30	B21	100
A25	30	B22	50
A26	Kabinet Art 30	B23	Kabinet Routers Sëitçes 50
A27	30	B24	Kabinet IT/35



A31	60	B31	Kabinet IT/35
A33	30		
<b>Total</b>	<b>695</b>		<b>790</b>

Tabela 3. Struktura e hapësirave për ligjërata është e shpërndarë në dy hyrjet e objektit të UKZ-së: A dhe B.

Stafi i universitetit janë të pajisur me laptop, pajisje lëvizëse për ruajtjen e të dhënave si USB, ndërsa zyrat e tyre janë të pajisura me kompjuter desktop dhe printerë për të përmirësuar efikasitetin e punës. Për të siguruar një ambient të përshtatshëm mësimor, programi është e pajisur me fotokopjues dhe material shpenzues të nevojshëm, duke përfshirë letër dhe toner për fotokopjues. Sallat e mësimimit janë të pajisura me projektorë për të mundësuar prezantimet multimediale dhe një përvojë mësimore më dinamike. Përveç sallave të mësimimit në universitet janë disa laboratorë të informatikës, të cilat janë të pajisura me kompjuterë dhe pajisje të tjera teknologjike në nivel të lartë, që mund të shërbejnë si hapësira për zhvillimin e hulumtimeve të gjera sociale.

Në hapësirat e UKZ-së në Gjilan, ekziston një strukturë e mjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve mësimore. Struktura e hapësirave duke përfshirë zyrat e administratës, sallave të mësimimit, laboratorëve, kabineteve, bibliotekës etj., paraqitet me anë të tabelës në vijim. Universiteti ka dy salla të vogla, të cilat janë të paisura me mjete të nevojshme teknologjike dhe shërbejnë ekskluzivisht vetëm për hulumtime grupore.

	Përdoren nga stafi akademik	Përdoren nga stafi administrativ	Përdoren nga studentët	Total kompjuterë
Numri i përgjithshëm i kompjuterëve	97	48	125	218

Tabela 4: Numri total i kompjuterëve (desktop dhe laptop) funksionalë që disponon universiteti.

Lloji i pajisjes	Numri total i pajisjeve
Projektor	45
Smart Board	13
Smart TV	6
Makinë fotokopjuese	19
Printer	85
Kompjuterë në laboratorë të Informatikës	110
Kompjuterë për stafin akademik	70
Kompjuterë për administratë	38
Laptop	52
Printer për ID-kartela	1
Lexues Optik	1
ËiFi (Modem)	55
Server	2
Pajisje Laboratorike	15
Grafoskop	13
Kamera të sigurisë	58
Aparat Profesional Fotografik	4
Router	6

Sëitch të menaxhueshëm	25
Sëitch të thjeshtë	15
UPS	50
Scanner	4

Tabela 5: Numri total i pajisjeve të tjera teknologjike funksionale që disponon universiteti.

Përveç pajisjeve të listuara më lartë, Universiteti ka përfituar grante nga projektet e ndryshme si: Euforia, ReBus, E viva, Quadic etj, përmes të cilave grante ka pasuruar fondin e pajisjeve të ndryshme që i lehtëson aktivitetet akademike.

Lloji i pajisjes	Numri total i pajisjeve
Laptop	108
Desktop Lenovo ALL IN ONE	60
Video Projektor	15
Mobile Projektor	4
Aparat Proffesional	1
Printer Multifunksional	5
Printer 3D	2
Kamera Ultra HD	2
Kompjuter Desktop	18
Video Conference Sound System – Online learning equipment	4

Tabela 6: Pajisje të mundësuar nga grante dhe projekte të ndryshme

Universiteti ka në dispozicion bibliotekën e cila në fondin e saj ka literaturë në gjuhën shqipe, angleze, serbokroate dhe një fond më të kufizuar në gjuhën greke, spanjolle dhe turke.

Fondi i përgjithshëm i librave është 54,000 ekzemplarë. Përveç bibliotekës së universitetit, studentët mund të shfrytëzojnë edhe literaturën e cila gjendet në Bibliotekën e Qytetit “Fan S. Noli” në Gjilan. Me qëllim të begatimit të titujve të librave në bibliotekën e UKZ-së është lidhur marrëveshje me Rrjetin e Bibliotekave Elektronike të Kosovës. UKZ është pjesë e projektit Erasmus+ “ResearchCult” me anë të cilit do të krijohet qasja në një bibliotekë ndërkombëtare; UKZ furnizohet me libra edhe nëpërmjet projekteve Erasmus+, si me SMAHPS, ENEMLOS etj.

Përdoruesit mund t’i qasen bazave të të dhënave dhe burimeve të cilat janë pa pagesë si dhe atyre në kuadër të databazat e [Universitetit në rrjete ndërkombëtare](#).

Procesi i digjitalizimit të Bibliotekës është në vazhdim. Staf i është i trajnuar për softuerin COBISS. Zyrtarja e bibliotekës është e licencuar për përdorimin e këtij softueri dhe është duke regjistruar librat në sistem. Biblioteka punon nga ora 8 deri në 16. Salla e leximit në bibliotekë është e qasshme dhe e shfrytëzueshme prej të hënës deri të shtunën nga ora 8 deri 20.

UKZ blenë libra dhe mjete të tjera edukative njëherë në vit, apo edhe sipas nevojës. Biblioteka pasurohet nga burime të ndryshme, si burime të brendshme nga universiteti dhe nga burime të jashtme si: GIZ-i, ASHAK, MASHT-i, Erasmus +, QATEK, SMAHPC, ASHSH, Instituti i Historisë në Prishtinë, dhurata nga profesorët e universitetit si dhe nga autorë të jashtëm. Gjithashtu, Universiteti ka nxjerrë rregullore sipas së cilës, çdo autor obligohet t’i dorëzoj 10 ekzemplarë në bibliotekën e Universitetit (Rregullore për punën e Këshillit Botues).

UKZ ofron kushte për personat me nevoja të veçanta (psh. hyrja, ashensori, banjo, përcjellja etj). Nga data 24.02.2023 UKZ ka bërë furnizimin dhe montimin me lift me Standardet konform Rregullores se Ministrisë se Tregtisë se Kosovës (MTI) me Nr. 03/2017, per sigurinë e ashensorëve ne përdorim. Lifti ka përmbushë standardin Kosovar SK EN 81 – 20:2014 dhe SK EN 81-50:2014, Rregullat e Sigurisë per konstruktimin dhe instalimin e ashensorëve, i cili shërben për gjithë stafin e UKZ-së dhe për të gjithë studentët të cilen kanë nevojë për shfrytëzimin e tij ( për katet 1,2, dhe 3) , me certifikatën e konformitetit me numër 039/2023 te dhëne nga trupi inspektues “EALGA “ SH.P.K nga Prishtina.

#### Plani i veprimit

Nr.	Aktiviteti	Periduha kohore	Kosotja buxhetore	Përgjegjësia	Komente
1.	Funksionalizimi i Këshillit të Fakultetit të Shkencave Sociale	Tetor-Nëntor 2024	100 Euro	U.D. Dekanë Sekretari	
2.	Forimimi i një grupi punues për shqyrtimin e syllabusëve të lëndëve të programit, për të zbatuar rekomandimet e eksperetëve të akreditimit, miratimi i ndryshimeve në Këshill të Fakultetit.	Dhjetor 2024- Janar 2025	-	Dekani, Këshilli i Fakultetit	
3.	Formimi i grupit punues për vlerësimin, rishikimin e mënyrës, formës së zënies së krediteve përgjatë shkëmbimeve të studentëve dhe miratimi i kornizës për relizimin e praktikës për student.	Shkurt – Prill 2025	100 Euro	Dekani, Këshilli i Fakultetit Sekretari	
4.	Formimi i Këshillit të Stakeholderëve të Fakultetit.	Mars – Maj 2025	650 Euro	Dekani, Këshilli i Fakultetit Sekretari	Realizimi i takimeve të ndara dhe organizimi i mbledhjes së përbashkët.
5.	Formalizimi i marrëveshjeve të para me stakeholder dhe partnerë të tjerë	Mars- Qershor 2025	350 Euro	Dekani, Këshilli i Fakultetit Sekretari	
6.	Funksionalizimi i laboratorit të Shkencave Sociale	Mars – shtator 2025	6500 Euro	Dekani	Shihet mundësia për të fituar donacion rregullimin e laboratorit.

7.	Zhvillimi i projektit të parë hulumtues nga stafi dhe studentët	Maj – Dhjetor 2025	5000 Euro	Dekani, Këshilli i Fakultetit SSL	Shihet mundësia për mundësi financimi nga donatorët
8.	Hulumtimi i nevojave të stafit mbi ngritjen e kapaciteteve (përcaktimi i prioriteteve); Zhvillimi i një koncepti bazik mbi realizimin e ngritjes së kapaciteteve të stafit;				
9.	Zhvillimi i partneriteteve institucionale në hulumtime kërkimore	Janar – Dhjetor 2025	500 Euro	Dekani, Këshilli i Fakultetit	
10.	Organizimi i trajnimit mbi metodologjitë dhe teknikat e reja të mësimdhënies.	Prill – Qershor 2025	2000 Euro	Dekani	Shihet mundësia për organizim nga partnerët
11.	Organizimi i trajnimit mbi realizimin e kërkimeve shkencore	Prill – Shtator 2025	2000 Euro	Dekani	Shihet mundësia për organizim nga partnerët
12.	Mbajtja e trajnimit mbi përdorimin e PCCheck	Nëntor 2024	-		Organizimin i Rektoratit
13.	Mbajtja e trajnimit në googleclassroom,	Shkurt 2025	-	Dekani	
14.	Njohja e studentëve me kodin e etikës	Mars 2025		Dekani, Sekretari	
15.	Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënësve për kurset adekuate nga Fakulteti	Janar 2025	-	Dekani, Sekretari	
16.	Propozohet që angazhimet për vitin akademik 2025/2026 të bëhen për një periudhë 1 vjeçare.	Qershor 2025		Dekani	
17.	Inicimi i plotësimit/ndryshimit të rregullores për të ardhurat personale, me qëllim rritjen e kompensimit për stafin e angazhuar.	Dhjetor – Janar 2024	-	Dekani	
18.	Identifikimi dhe zhvillimi i takimeve për arritjen e Memorandumeve të bashkëpunimit me Fakultete që kanë qëllime të përafërta	Janar 2025- Dhjetor 2025		Dekani Këshilli i Fakultetit	
19.	Realizimi i 6 aktiviteteve në programin Guest Speake (Këshilli vendos për emërtim të programit)	Dhjetor 2024 – Dhjetor 2025	900 Euro	Dekani, Këshilli i Fakultetit, Sekretari	

20.	Indetifikimi i nevojave aktuale për financimin bazë, studentët, stafin.	Janar 2025- Qershor 2025			
21.	Hartimi i planit të rreziqeve për Fakultetin	Shkurt 2025-Maj 2025	300 Euro	Këshilli i Fakultetit	
22.	Inicimi i procedurës për organizimi i kurseve të përbashkëta të njësive akademike, një kurs mund të ndiqet nga studentët e FSHS-së në Fakultetet tjera.	Shkurt 2025 -Qershor 2025		Dekani	
23.	Blerja e 200 titujve të librave për FSHS	Prill 2025 – Dhjetor 2025	3000 Euro	Dekani Këshilli i Fakultetit	
24.	Inicimi i procedurës në Menaxhmentin e UKZ-së, për krijimin e qasjeve nëpër biblioteka elektronike.	Prill 2025- Shtator 2025	-	Dekani	
25.	Arritja e marrëveshjeve për shfrytëzimin e bibliotekave të qyteteve, instituteve, Universiteteve në Kosovë dhe ato elektronike në rajon.	Maj 2025 – Nëntor 2025		Dekani	
26.	Do të inicohet procedura në menaxhmentin e UKZ-së për të krijuar qasje në databaza shkencore për staf dhe student të fakultetit / programit	Mars 2025 – Nëntor 2025	-	Dekani	
27.	Rritja dhe përmisimi i hapsirave të Fakultetit	Shkurt 2025- Dhjetor 2025			
28.	Mbajtja e trajnimit mbi termat dhe teknikat e zbulimit të tekstit bazik të AI nga studentët.	Mars – Nëntor 2025	2000 Euro	Dekani	Shihet per mundesi qe te organizohet nga partneret
29.	Të inicohet ndryshimi i kodit të etikës, në lidhje me përdorimin e AI në punën e stafit dhe studentëve.	Dhjetor 2024 – Mars 2025		Dekani	
30.	Realizimi i trajnimit të stafit për hartimin e projekt propozimeve (ndërkombëtare).	Mars – Nëntor 2025	2000 Euro	Dekani	Shihet per mundesi qe te organizohet nga partneret

31.	Zhvillimi I kornizës tre vjeqare të buxhetit të dedikuar për programin MNSE	Dhjetor 2024		Dekani, Zyra e financave	
<b>Totali në Euro</b>			25,400 Euro		